

EDMOND MALAJ

**DUKAGJINËT GJATË MESJETËS.  
SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E TROJEVE DHE DISA  
KARAKTERISTIKA**

Për Dukagjinët kanë shkruar tashmë disa autorë qoftë të huaj, qoftë shqiptarë. Mund të përmend këtu historianin Paolo Petta, i cili në librin e tij *“Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë”*<sup>1</sup> u kushton Dukagjinëve një hapësirë të caktuar. Më tej, në lidhje me ta na informon edhe historiani zviceran Oliver Jens Schmitt në librin e tij *“Skënderbeu”*<sup>2</sup>. Një studim (kapitull libri) të shkëlqyer ka botuar edhe studiuesi serb Ivan Božić me titull *“Rreth Dukagjinëve” (O Dukadinima)*, në vitin 1979<sup>3</sup>.

Ndër studiues shqiptarë mund të përmendim Luan Malltezin, i cili në një artikull të tij me titull *“Skënderbeu dhe Dukagjinët”*<sup>4</sup> pasqyron shumë mirë marrëdhëniet e tyre me Heroin Kombëtar.

Në këtë artikull unë do të paraqes një histori të përgjithshme të Dukagjinëve, nga origjina deri në shuarjen e tyre, duke u përqendruar kryesisht në vazhdimësinë e tyre pas pushtimit osman jashtë trojeve



**Fig. 1:** Stema e Dukagjinëve. Gjin Varfi, *Heraldika shqiptare*, f. 45.

<sup>1</sup> Paolo Petta, *Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë. Mërgata shqiptare në Italinë e periudhës së Rilindjes*, përktheu nga italishtja Pëllumb Xhufi, Tiranë: IDK, 2000, f. 229.

<sup>2</sup> Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, përktheu në shqip Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2008, f. 201-212.

<sup>3</sup> Ivan Božić, “O Dukadinima”, në Ivan Božić, *Nemirno pomorje XV veka*, Belgrade: Srbska Književna Zadruga 1979, f. 332-384.

<sup>4</sup> Luan Malltezi, “Skënderbeu dhe Dukagjinët”, në *Skënderbeu dhe Evropa (Përmbledhje kumtesash)*, përgatiti për botim dhe redaktimi shkencor nga prof. dr. Ferit Duka, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2006, f. 83-102.



Karakteristikë e tyre nuk është vetëm numri i madh i familjeve të tyre që u përkasin degëzimeve të ndryshme të farefisit, por edhe grindjet që kanë pasur këto familje midis tyre, edhe pse i përkisnin të njëjtit farefis.<sup>8</sup>

Roli i tyre në historinë politike të asaj kohe është mjaft i madh dhe arrin kulmin gjatë periudhës së Skënderbeut<sup>9</sup> dhe pas vdekjes së tij. Gjatë kësaj kohe spikat kryesisht figura legjendare e Lekë Dukagjinit, për të cilën më vonë u thurën edhe gojëdhëna dhe legjenda, të cilat kanë ardhur përmes traditës gojore deri në ditët e sotme.<sup>10</sup>

Zotërimet e tyre (shih Fig. 2) gjendeshin në veri të trojeve shqiptare dhe shtriheshin kryesisht në veriperëndim nga Zadrimeja e Sipërme deri në Ndërfandinë dhe në verilindje deri në pikën ku bashkohen Drini i Zi me Drinin e Bardhë, duke përfshirë brenda saj, krahina përreth Lezhës, krahinën e Dukagjinit dhe të Rrafshit të Dukagjinit që sot gjendet në Kosovë.<sup>11</sup>

Megjithatë krahina e sotme e Dukagjinit si toponimi filloi të përdorej kryesisht gjatë periudhës osmane e më vonë, sepse krahina e Dukagjinit, duke përfshirë edhe disa troje, ku kanë qenë zot Dukagjinët në Mesjetë kishte emrin Pulatum (shq. Pult) dhe ndahej në Pultin e Sipërm dhe Pultin e Poshtëm.<sup>12</sup> Krahinën kryesore ku ata kanë qenë zot, duhet ta kërkojmë kryesisht në Zadrime<sup>13</sup> dhe ndërmjet viseve të Lezhës

<sup>8</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 229.

<sup>9</sup> L. Malltezi, "Skënderbeu dhe Dukagjinët ...", f. 83-102.

<sup>10</sup> Në lidhje me legjendat mbi Lekë Dukagjinit shih ndër të tjera edhe: "Gojëdhëna për Lekë Dukagjinit", në Patër Zef Jankaj, *Krijimtari gojore (Krajë - Malësi)*, përgatitën për botim Zef Anton Gjuravçaj – Patër Mirash Marinaj, Tuz: Misioni Françeskan në Malësi, 2007, f. 242-247.

<sup>11</sup> Aleksandër Buda, "Dukagjinët", në *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. I (A-Gj), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f. 542; shih edhe: Aleksandër Buda, "Dukagjinët", në *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: Shtypshkronja e Re, 1985, f. 212; shih edhe: L. Malltezi, "Skënderbeu dhe Dukagjinët ...", f. 84.

<sup>12</sup> *Light and Shadow, Isolation and Interaction in the Valley of Northern Albania*, editors: Michael L. Galaty, Ols Lefe, Wayne E. Lee, Zamir Tafilica. Los Angeles: Cotsen Institute Of Archeology Press (University of California) 2013, f. 53. (=Monumenta Archeologica 28)

<sup>13</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens) (Nr. 555 et passim) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen., nr. 413. (më tej: AAlb)

e të Fanit, të cilët duhet të kenë qenë pasardhësit e linjës së Tanush II Dukagjinit, të birit të Lekës I.<sup>14</sup> Një ndër stemat e Dukagjinëve është shqiponja e bardhë njëkrerëshe, ndërsa vulën e tyre nuk e dimë.<sup>15</sup>

### **Të dhëna mbi zanafillën dhe familjet e ndryshme të Dukagjinave**

Sipas një gojëdhëne që na sjell Gjon Muzaka (Memoriet), origjina e largët e Dukagjinëve ishte nga Troja, pasi ishin shpërngulur në Francë në Kohën e Kryqëzave dhe pikërisht gjatë kësaj kohe një paraardhës i tyre kishte shoqëruar mbretin frëng në një kryqëzatë në Jerusalem.<sup>16</sup> Dy vëllezër pastaj kishin shkuar në Itali dhe aty qëndroi njeri prej tyre që ishte paraardhësi i shtëpisë Ferrare, kurse tjetri Dukë Gjini erdhi në trojet shqiptare, ku pushtoi zonën e Zadrimës, Malin e zi (në afërsi të Zadrimës) Fanin dhe Flatin, ku ndërtoi dhe kështjellën e Fletit<sup>17</sup>. Gjithsesi, të dhënat që jep Gj. Muzaka duhet të merren me rezerva të mëdha, jo vetëm për Dukagjinët, nga të cilët vinte bashkëshortja e tij Maria Dukagjini, por edhe për familjet e tjera.<sup>18</sup> Sipas një kronike raguzane, e cila gjithashtu bazohet në gojëdhëna, origjina e tyre e ka zanafillën diku në shek. VII. Këtu Dukagjinët përmenden si shkaktarë kryengritjesh në Bosnjë dhe se kishin ndërhyrë dy herë në Raguzë.<sup>19</sup>

Sidoqoftë, i pari pjesëtar i këtij fisi bujar njihet Dukë Gjini Tanushi apo Gjini Dukagjini (Ginus Ducaginus) i përmendur në fund të shek.

<sup>14</sup> Milan Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, përktheu nga kroatishtja Hasan Çipuri, Tiranë: Toena, 2004, f. 158; shih edhe: Gjon Muzaka, *Memorie*, përktheu Dhorë Qirjazi, Tiranë: Toena, 1996, f. 41.

<sup>15</sup> Milan Shufflay, *Histori e Shqiptarëve të Veriut (Studim Sociologjik)*, përktheu Abdullah Konushevc, Prishtinë: Nositi, 2009, f. 33.

<sup>16</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 307; O. Schmitt, *Skënderbeu...*, f. 201.

<sup>17</sup> Johann Georg von Hahn, "Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar. Dritte Abtheilung: Beiträge zur Geschichte von MittelßAlbanien nach den Funden des Herrn Prof. Dr. Karl Hopf", në *Denschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Philosophisch-historische Klasse. Sechzenhnter Band. Wien: aus der Kaiserlich-Königliches Hof- und Staatsdruckerei 1869*, f. 122; shih edhe: Gj. Muzaka, *Memorie ...*, f. 40.

<sup>18</sup> J. G. von Hahn, "Beiträge...", në *Denschriften ...* 16, f. 122; Gj. Muzaka, *Memorie ...*, f. 40.

<sup>19</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. I, f. 307; L. Mallezi, "Skënderbeu dhe Dukagjinët ...", f. 83.

XIII, i cili kishte dy djem Gjergj Dukagjinin, të lindur në vitin 1349 dhe Antanazius Dukagjinin për të cilin nuk jepet një datë lindjeje.<sup>20</sup> Titullin e tij *Dukë* (1281 *ducam Ginium Tanuschium Albanensem*) ai duhet ta ketë marrë gjatë kohës kur ka shërbyer si oficer në shërbim ose të ushtrive bizantine<sup>21</sup> ose të atyre serbe.<sup>22</sup> Duka Gjini që zënë rob prej kapitenit të Durrësit dhe më vonë, siç duket, u vra nga malësorët katolikë që udhëhiqeshin nga abatët benediktinë të Ndërfandinës (Trafandina).<sup>23</sup>

Gjon Muzaka në lidhje me këtë vrasje thotë që zoti Dukagjini që vvarë nga vasalët e tyre në fshatrat e Ndërfanit, pasi peshkopi i kësaj dioqeze ia kishte vështruar në mënyrë jo të ndershme gruan [me lakmi – E.M.], dhe Duka Gjini e vrau këtë peshkop në kishën e Shën Mërisë së Ndërfanit.<sup>24</sup> Sipas Hahnit, kjo histori është shumë e ngjashme me gojëdhënat e asaj krahine.<sup>25</sup> Hakmarrja shkon edhe përtej vrasjes së Dukës Gjini, sepse përveç tij vritet edhe krejt shtëpia e tij dhe nuk shpëtoi tjetër veç një fëmijë i vogël që që fshehur dhe që marrë e që edukuar nga një Stefan Progani i fshatit Kallmet.<sup>26</sup> Emri i djalit nuk përmendet. Stefan Progani më vonë i dha këtij djali vajzën e tij për grua dhe e ndihmoi që të rifitonte



Fig. 3: Një emblemë e dytë e Dukagjinëve. Gjini Varfi, *Heraldika shqiptare*, f. 46.

<sup>20</sup> *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*. Prior Familias ac Stemmata imperatorum Constantinopolitarum, cum corundem Augustorum Nomismatibus, & aliquod Iconibus; Præterea Familias Dalmaticas & Turcicas complectitur: Alter Descriptionem Urbis Constantinopolitanæ qualis extitit sub Imperatoribus Christianis. Auctore Carolo Du Fresne Domino Du Cange, Regi a Consiliis, Francæ pud ambianos Questore. Venetiis, Ex Typographiæ Bartolomæi Javarina M. DCC. XXIX, f. 167.

<sup>21</sup> I. Božić, "O Dukadinima...", f. 334.

<sup>22</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët...*, f. 158; *Light and Shadow ...*, f. 53; shih edhe: I. Božić, "O Dukadinima...", f. 334.

<sup>23</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët...*, f. 158.

<sup>24</sup> J. G. von Hahn, "Beiträge...", në *Denschriften ...* 16, f. 122; Gj. Muzaka, *Memorie ...*, f. 41.

<sup>25</sup> J. G. von Hahn, "Beiträge...", në *Denschriften ...* 16, f. 122.

<sup>26</sup> Po aty.

pronat që më parë i kishte poseduar i ati. Ata patën shumë bij dhe nipa e mbesa, nga të cilët Gjon Muzaka mban mend vetëm tre prej tyre që ishin vëllezër, Gjergjin, të dokumentuar në vitin 1403 nga Hopfi, zot të Zadrimës, Vunon (Vukon) ose Tanushin, zotin e Fanit dhe të tretin Dukagjinin, i cili posedonte tetë fshatra në Zadrimë dhe qe paraardhësi i degës së Dukagjinëve që ndodheshin në qytetin e Shkodrës.<sup>27</sup>

Megjithatë historia e tyre është e dokumentuar kryesisht në shek. XIV-XV. Gjatë shek. XIV gjejmë dokumente që dëshmojnë për marrëdhënie dhe marrëveshje të dukagjinave me Raguzën dhe raguzanët. Një dokument i vitit 1377 flet për pagesën e një borxhi që Nikollë Tudoreviq Dukagjini (*Nicolaus Tudorevich Duchagin*) ia kishte një fisniku raguzan të quajtur Vita de Goçe<sup>28</sup>.

Ndërsa rëndësi të veçantë përbën marrëveshja apo diploma e Lekë Dukagjinit I, e bërë në vitin 1387.<sup>29</sup> Këtu nuk bëhet fjalë për Lekë Dukagjinin (III) që ka jetuar në kohën e Skënderbeut, por një figurë më të hershme që ishte i vëllai i Pal Dukagjinit dhe, mesa duket, i ati i Tanush dhe Progon Dukagjinit, zotërve të Lezhës.

Marrëveshjen në fjalë, po e sjellim më poshtë të përkthyer nga sllavishtja mesjetare nga Atë Gjon Shllaku OFM: *“Lekë Dukagjini I. u shkruhen Raguzinve! Prej Lekë Dukagjinit e Palit vllaut t’ëm të lartëve të nderitit qytet të Dubrovnikut shkruet n’ëmen t’ëm e t’ëm vllá, shkoni lirisht në tokë t’ëme mos kini frigë gjá, por për shka i përket doganës lanje si mbas ligjës doganën qi u keni lá*

*perpara atyne të lartëve qi kan banue në ket vend e mos kini frigë pse na kemi bâ pagjë me Turq e Zoti ju gëzofhtë. Në shpinë: Të lartëve të nderitit qytet të Raguzës. Dita e parafundit e Dhjetorit 1387”.*<sup>30</sup> Në këtë diplomë



**Fig. 4:** Emblemë tjetër e Dukagjinëve. Gjin Varfi, *Heraldika Shqiptare*, f. 47.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> AAlb II, nr. 340; I. Božić, “O Dukadinima...”, f. 335.

<sup>29</sup> P. Gjon Shllaku, “Dokumenta historije. Lekë Dukagjini I u shkruhen Raguzinve”, *Hylli i Dritës (XVIII)* 1940, 12, f. 83.

<sup>30</sup> Po aty. (Origjinali ruhet në Arkivin e Dubrovnikut, Div. Canc. 1386-II, 38) Teksti origjinal në sllavisht “*Od Leke Dukagin i Pavla brat mu vlastelom(i) č(e)st(e)noga*

çuditërisht nuk shënohet as logofeti (skriba) i Lekës dhe as vendi ku është përpiluar ajo. Përveç kësaj i mungon dhe ndonjë element i zakonshëm (klishe) që ndeshet në diploma të këtij lloji.<sup>31</sup> Ky dokument vërteton faktin që Dukagjinët, ashtu si edhe Balshajt, Kastriotët, etj., kishin kancelari sllave.<sup>32</sup>

Në shek. XIV, siç u përmend edhe më sipër, për një farë kohe Dukagjinasve u përkiste edhe qyteti i Lezhës, të cilin e humbin Tanush Dukagjini me të vëllanë Progonin (të bijtë e Lekë I Dukagjinit) me anë të një marrëveshjeje të bërë në vitin 1393<sup>33</sup>.

Qytetin ata ia lëshojnë venedikasve, me kusht që të kishin nga ky qytet një të tretën e të gjithë prodhimit,<sup>34</sup> të gëzonin edhe më tej pronësinë e pesë vilave të mëdha me shtëpi përreth (*casalia*) të cilat ishin nën zotërimin e kështjellës së Lezhës, të mos linin armiq dhe rebelë të Dukagjinëve që të vendoseshin në territoret e këtij qyteti.<sup>35</sup> Lëshimin e qytetit në duart e venedikasve, ata mesa duket e kishin bërë për shkak të kërcënimit të turqve që ishte bërë gjithnjë e më i pranishëm. Këtë supozim e mbështet edhe një dokument i një viti më vonë, ku flitet për sulme nga ana e turqve mbi fshatrat e Lezhës që kishin mbetur nën zotërimin e Dukagjinëve.<sup>36</sup>

Emri i Progon Dukagjinit të sipërpërmendur na shfaqet edhe në dokumente të tjera të vitit 1394, në lidhje me lejen që i kërkon Voislava

---

*grad Dubrovnika pišu vera vi moja i moga brat grdet slobo dno po moei zemli ne boite se ništa a jer je za carinu davaite se zakon(e)nu carinu što ste prge davali inema vlasteloma koi su prge nastonjeki na tema meste bil a nied(n)oga strah se ne boite jer se umiriha s Tur(e)ci i Bog(e) vi veseli. Vlastelom(e) č(e)st(e)noga grad Dubrovnika pišu. Die penultimo Dec. 1387.*” Po aty.

<sup>31</sup> M. Ahmeti, “Dukagjinët...”, në *Rilindasi*, suplement i gazetës *Shqiptarja.com*, viti IV, nr. 301, datë 21.12.2014, f. 19.

<sup>32</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët...*, f. 170.

<sup>33</sup> *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Prima: Saeculum XIV complectens. Tomus Primus: Ab initio ad usque annum MCCCLXXXIV. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma 1967, nr. 497. (më tej: AAV)

<sup>34</sup> AAlb II, nr. 501, 517; AAV I, nr. 542; shih edhe: *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV. I. (1400-1405)*, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë Tiranë: 1987, dok. nr. 101.

<sup>35</sup> AAV I, nr. 497; shih edhe: AAlb II, nr. 501.

<sup>36</sup> AAlb II, nr. 517.

Topia, e motra e Gjergj Topisë (*domina Voislava soror quondam domini georgij Topie domini durachij*), zotit të Durrësit, për t'u martuar me Progonin.<sup>37</sup> Leja i jepet asaj më 16.7.1394.<sup>38</sup> Kjo martesë dëshmon edhe për lidhjet e Dukagjinëve me familje të tjera të fuqishme fisnike, siç ishin në këtë rast Topiajt. Ndër lidhje të tjera mund të përmendim edhe martesën e Maria Dukagjinit me Gjon Muzakën.<sup>39</sup> Disa vite më vonë, në një dokument të datës 27 maj 1402, marrim vesh që pikërisht Progoni i sipërpërmendur, i biri i Lekës (*Progamus filius quondam Leche Duchaino*), ishte vrarë duke luftuar për Venedikun në muret e kështjellës së Shatit.<sup>40</sup> Po në këtë dokument, flitet edhe për një Progon Dukagjini tjetër, vëlla i Palit (*quidam Progamus, Frater dicti Pauli*), kushëri me të sipërpërmendurin, besnik i venedikasve, i cili kishte vdekur në Dalmaci.<sup>41</sup>

Të drejtën e të tretës së të gjithë prodhimit, për të cilën u fol më sipër, ata e humbin më vonë, sepse më 8 prill të vitit 1401 paraqitet në Senatin e Venedikut një fisnik i quajtur Johan Barbo, i cili kërkon që të vendoset një administrator në Lezhë për kontrollin e këtyre të ardhurave që më parë u përkisnin Dukagjinëve.<sup>42</sup> Sesi kishte ndodhur kalimi i këtyre të drejtave nga Dukagjinët tek venedikasit, kjo në dokument nuk bëhet e qartë. Mbase shkakun duhet ta kërkojmë tek vdekjet e disa pjesëtarëve të kësaj familjeje (Tanushi dhe Progani [Progami – E.M.], të bijtë e Lekës nuk jetonin më), të cilët kishin qenë pjesëmarrës në marrëveshje dhe mbrojtës të saj.

Le të hedhim tani shkurt një vështrim edhe një linjë tjetër të këtij farefisi, pjesëtarë të së cilës përmenden nëpër dokumente herë pas here. Në një dokument të datës 27 maj 1402 përmenden tre vëllezër Pal, Tanush dhe Progam Dukagjini të cilët kishin edhe vëllezër të tjerë. Progami në dokument cilësohet si besnik ndaj Republikës së Venedikut. Në këtë dokument përmenden edhe kushërinjtë e tyre, Lekë Dukagjini II

<sup>37</sup> AAV I, nr. 549.

<sup>38</sup> AAV I, nr. 553.

<sup>39</sup> J. G. von Hahn, "Beiträge...", në *Denschriften ...* 16, f. 121. Gj. Muzaka, *Memorie...* f. 41.

<sup>40</sup> "...et quidam Progamus filius quondam Leche Duchaino consanguineus suus etiam fidelis nostri domini pugnando pro honore nostri domini sub castro Satti fuit mortuus...". AAlb II, nr. 694.

<sup>41</sup> "Progamus frater dicti Pauli [...] mortuus in partibus Dalmatie". AAlb II, nr. 208; AAlb II, nr. 694; I. Božić, "O Dukadinima...", f. 340.

<sup>42</sup> AAlb II, nr. 667.

me të birin Progamin (II), i cili cilësohet si besnik ndaj Venedikut dhe që ishte vrarë duke luftuar për nder të zotërimit venedikas në kështjellën e Shatit.<sup>43</sup> Tre vëllezërit e sipërpërmendur Pal, Tanush dhe Progami Dukagjini, e ndjenin veten të rrezikuar nga kërcënimi turk dhe i kërkojnë Republikës Venedikase ndihmë dhe strehim të familjeve të tyre në Shkodër, qytet shqiptar që në atë kohë i përkiste sundimit venedikas. Kjo kërkesë e tyre përmbushet dhe përveç lejes së strehimit të grave dhe të fëmijëve të tyre në Shkodër, atyre u jepet nga një kalë dhe një rrogë prej tre dukatësh ar në muaj.<sup>44</sup>

Në dy dokumente venedikase të vitit 1403 përmendet Gjergj Dukagjini, një feudal i vogël dhe vasal shumë besnik ndaj venedikasve, i cili kishte marrë nga kontkapideni venedikas i qytetit të Shkodrës administrimin e fshatrave Balldren dhe Kakarriq. Aty ai kishte krijuar edhe një ushtri të vogël prej 50 kalorësish dhe 100 këmbësorësh dhe kërkonte nga Venediku që t'i falej edhe taksa, një të dhjetat që nxirreshin nga këto fshatra, me qëllim që të mbante ushtrinë e tij të vogël që do të vihej nën urdhrat e rektorëve venedikas po të ishte nevoja. Kjo taksë atij nuk iu hoq, por në këmbim iu premtua një dhuratë prej 60 perperësh që do ta merrte të ndarë me dy afate, njëren pjesë për festën e Shën Pjetrit dhe pjesën tjetër për ditën e Pashkëve. Dhe krahas kësaj do t'i jepeshin edhe 12 krahë stof për të bërë për vete një klamide\* dhe një kapuç për nderin e zotërimit venedikas.<sup>45</sup> Dhurimi i stofit vërtetohet edhe një herë në një dokument të mëvonshëm të datës 9 korrik 1403.<sup>46</sup>

Një linjë tjetër e cila është më pak e dokumentuar dhe haset me përcaktimin si “Linja e Vjetër” apo “Dukagjinët e vërtetë”, të cilët mesa duket ishin vendosur në Shkodër, por që kishin prona edhe në Zadrimë është ajo e Palit, të atit të Nikollës († para vitit 1454), bir i të cilit ishte Draga Dukagjini († para ose gjatë vitit 1462)<sup>47</sup>, për të cilët nuk kemi shumë të dhëna. Ata kishin prona edhe në Zadrimë dhe pas vitit 1458, Draga kërkonte që Sinjoria t'i njihet atij Shatin (Satti), pasi pretendonte

<sup>43</sup> *Dokumente për Historinë e Shqipërisë...*, I (1400-1405), dok. nr. 215.

<sup>44</sup> *Po aty*.

\* Veshje mesjetare.

<sup>45</sup> “[...] *bracia xij panni, pro possendo kacere sibi nam clamidem ed vnum caputeum ad honorem nostri dominij*”. *Dokumente për Historinë e Shqipërisë ...*, I (1400-1405), nr. 329.

<sup>46</sup> *Po aty*, nr. 353.

<sup>47</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu...*, f. 203.

që dikur atë e kishte poseduar i ati i tij Nikolla.<sup>48</sup>

Në lidhje me Dukagjinët e Shkodrës, Ivan Bozhiq përmend disa prej tyre, si p.sh. vëllezërit Andrea Dukagjini (para vitit 1406), i cili kishte marrë me qira një pellg që në fakt i përkiste ipeshkvit dhe bashkisë së Shkodrës, por që i paguante Venedikut për të<sup>49</sup>, dhe i vëllai i tij Gjon (Ivan) Dukagjini (prift), i cili kishte marrë me qira nga Venediku disa fusha në afërsi të Shkodrës, të cilat nuk pranonte t'ia kthente, kur Venediku donte t'ia jepte ato një tregtari katalonjas<sup>50</sup>. Një tjetër Dukagjinas i Shkodrës mund të përmendet Andrea, nipi i Andrea Dukagjinit të birit të Gjonit nga *Shkodra (Andrias Ducagin quondam domini Johannis de Scutaro)*, që mesa duket ishte tregtar por merrej edhe me çështje kreditesh.<sup>51</sup>

Si shembull tjetër mund të përmendim këtu Budimir Dukagjinin, i cili donte të merrte me qera disa pellgje rreth Shkodrës, të cilat i kishte Venediku aty në fillim të shek. XV, dhe të birin e tij të quajtur po ashtu Budimir, i cili merr pjesë në luftën e Shkodrës së rrethuar në vitin 1478, gruaja e të cilit me gjithë tre fëmijët iu lut Venedikut më 1 janar 1479 për ndihmë, dhe Senati vendosi që për aq kohë sa të vazhdonte rrethimi t'i paguheshin rreth 5 dukatë në muaj.<sup>52</sup> Në lidhje me këta Dukagjinë prej Shkodre, për shkak të të dhënave fragmentare që na japin qoftë studimet, qoftë burimet dokumentare, nuk është e mundur të bëhet një lidhje ndërmjet tyre. Pra nuk mund të themi nëse i përkisnin së njëjtës familje apo jo.

### **Linja e Lekës III Dukagjini (“autor” i Kanunit)**

Përsa i përket linjës së Lekë (III) Dukagjinit, që tradita e përcjell si “autor” të Kanunit (Kanuni i Lekë Dukagjinit), i njërës nga të drejtat zakonore shqiptare, në fillimshkullin XV njihen kryesisht vëllezërit Nikollë dhe Pal Dukagjini (që përmenden edhe në marrëveshjen e Lezhës 1393<sup>53</sup>), të cilët kishin marrë pjesë edhe në Kuvendin e Lezhës më

<sup>48</sup> L. Malltezi, “Skënderbeu dhe Dukagjinët ...”, f. 95.

<sup>49</sup> I. Božić, “O Dukadinima...”, f. 342.

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> Po aty.

<sup>52</sup> Po aty, f. 343.

<sup>53</sup> AAV I, nr. 497; AAlb II, nr. 501.

1444,<sup>54</sup> dhe në beteja përkrah Skënderbeut kundër turqve, siç ishte rasti i një lufte pas Betejës së Torviollit, ku morën pjesë edhe forcat e Pal Dukagjinit, dhe ku mbeti i vrarë një oficer i tij, i quajtur Marino Igraca.<sup>55</sup> Kurse i vëllai Nikollë Dukagjini, në lidhje me luftën kundër turqve njihej edhe më parë për udhëheqjen e një kryengritjeje antiosmane në vitin 1435 me anë të së cilës arriti të çlironte qytetin e Dejës, për shkak të së cilës më vonë Dukagjinët do të kishin konflikte me Zahariajt, siç do ta shohim edhe më poshtë.

Pal Dukagjini vdiq në moshën 61-vjeçare nga apoplezia, në vitin 1446.<sup>56</sup> Përsa i përket karakterit të tij disa të dhëna na i jep G. Biemmi në botimin “Historia e Skënderbeut”. Aty ai shkruan: “Në ditët e fundit të këtij viti (1446) vdiq nga një goditje apopleksie Palë Dukagjini në moshën 61 vjeç, nga të cilat 40 i kishte kaluar në zotërimin e territorit të tij. Ai ishte një princ i pajisur me të gjitha dhuntitë që mund ti duheshin një burri me një karakter të tillë si të tijin: fisnik në ndjenja; i fjalës në premtime; mirënjohës ndaj të mirave, liberal në marrëveshje e bisedime, dakord në ndëshkime, inteligjent në marrëveshje, dhe i aftë për t’ia dalë çdo lloj intrige nëpër marrëveshje, me sjellje të mirë dhe me hijeshi për të fituar kështu simpatinë dhe respektin e njerëzve; kështu që të gjithë e mbanin për të denjë e të aftë për të qeverisur një mbretëri të madhe”.<sup>57</sup>

Si bashkëluftëtar i Skënderbeut, pjesëmarrës në Kuvendin e Lezhës dhe anëtar i Lidhjes së dalë nga ky kuvend ai gëzonte, sipas Biemmit, jo vetëm respektin e princave të tjerë por edhe një vlerësim të lartë nga ana e vetë Skënderbeut: “Skënderbeu thoshte, që nëse Shqipëria do të kishte

<sup>54</sup> “Paolo Ducagini ch’era in Principe dei piu considerabili dell’Albania non tanto per l’esntisione del dominio, quato pel zelo che negl’incontri facea comparire per l’interesse della Religione. e ora maneggiavafi a tutto potere per ottener ajuto a Scander-begh contra il Turco Nicolò Ducagini fuo germano”. Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, seconda edizione, Brescia: Giammaria Rizzardi 1756, f. 30.

<sup>55</sup> *Po aty*, f. 51.

<sup>56</sup> *Po aty*, f. 99.

<sup>57</sup> “Negli ultimi giorni di queft’ anno morì da un colpo d’apoplezia Paolo Ducagini essendo d’anni 61. di cui n’avea speso nel dominio de’ suoi Stati poco meno di 40. Fu un Principe adornato ai tutte quelle doti che poteansi desiderare in un uomo del fuo carattere: nobiltà di sentimenti, cofianza nelle promesse, gratitudine a’ benefizj, liberalità nelle recognizioni, piacevolezza ne’caftighi, intelligenza per gli affari, e capacità di riuscire in ogn’intrigho per via di negozio, maniera e grazia per guadagnarsi l’affetto, e la stima degli uomini; cosicchè tutti il celebravano degno e capace di governare un grandissimo regno” G. Biemmi, *Istoria ...*, f. 99-100.

*më tepër princa kaq të zotë, e kaq bujarë si Pal Dukagjini, ajo do të bëhej shumë shpejt vendi më i lulëzuar i Botës. Vulpiano (Ulpiana?) (vendi ku ai kishte ngritur rezidencën e tij), kur ai e mori nga i ati, nuk ishte veçse një kështjellë e vogël dhe e varfër në të cilën banonin jo më shumë se 1500 persona, dhe kur ai vdiq, ajo është bërë tashmë një ndër qytetet më të pasura dhe më të populluara në Shqipëri, që arrinte në 15 mijë banorë; qyteti me gjithë këta banorë udhëhiqej nga fama e qeverisjes së tij të ditur dhe të moderuar. Vdekja e tij qe për Skënderbeun një humbje dhe një keqardhje e madhe, jo vetëm për shkak të miqësisë që ai kishte pasur nga ai, por edhe për shkak të humbjes së mbështetjes së tij për të mbajtur aleatët, sepse në mënyrën e tij ai mbante bashkimin dhe harmoninë midis aleatëve të tjerë”.*<sup>58</sup>

Lekë III Dukagjini ishte i biri i Pal Dukagjinit. Po e cilësojmë Lekën si Leka III, pasi krahas tij ka edhe të tjerë me të njëjtin emër.<sup>59</sup> Në Lidhje me Lekën III Dukagjini, Biemmi, duke u bazuar tek shkrintari anonim “Tivarini”, rreth ekzistencës së të cilët nuk kemi asgjë të konfirmuar as edhe sot, tregon edhe një përlëshje të madhe midis Lekë Dukagjinit dhe Lekë Zaharisë që ndodhi pikërisht në dasmën e Mamicës, motrës më të vogël të Skënderbeut, më 26 janar 1445, në qytetin Muzakie, për shkak të bijës së Gjergj Dushmanit, princit të Zadrimes, Irini Dushmanit<sup>60</sup>.

Irini ishte shumë e bukur dhe qe aty e pranishme bashkë me të atin midis të ftuarve në dasmë: “Prania e saj e ndezi gjithnjë e më tepër zjarrin e dashurisë tek të dy rivalët dhe ndodhi që një ditë shërbyesit e këtyre dy zotërinjve iu vërsulën u kacafytën midis tyre. Në çastin, kur u bë

<sup>58</sup> “Scander-begh dicea che se l’Albania avesse più Principi così bravi, e così generosi come Paolo Ducagini, ella divenirebbe ben presto il più florido Sato del mondo. Vulpiano, (luogo ove avea fatto la sua Residenza,) quando egli successe al Padre, non era che un picciolo, e povero Castello, in cui abitavano niente più di mille e cinquecento persone; quando egli morì, era fatto una delle più ricche, e più popolate Città dell’ Albania, che computava ben quindici mila abitanti: condottavi tanta quantità di gente dalla sola fama del suo savio, e moderato governo. La sua morte fu d’un grave rinascimento a Scander-begh, ma non folo per tante teftimonianze d’amicizia che avea ricevuto, quanto perchè considerava essergli mancato il sostegno di quell’ Alleato, il quale col suo esempio, e col suo maneggio tenea l’unione, e la concordia negli altri Alleati.” G. Biemmi, *Istoria ...*, f. 100.

<sup>59</sup> *Dokumente për Historinë e Shqipërisë...*, I (1400-1405), dok. nr. 215.

<sup>60</sup> Fan S. Noli, *Probleme biografike mbi Skënderbenë. Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1468-1968*, përgatitur nga Edward A. Licho, Federata Panshqiptare e Amerikës Vatra/Pan-Albanian Federation of America Vatra. Boston: Massachusetts 1968, f. 92; shih edhe G. Biemmi, *Istoria ...*, f. 85.

*kjo zhurmë që u kuptua si sinjal, u shfaqën Leka dhe Zaharija me gjithë njerëzit e tyre, të citët ishin të gjithë të armatosur dhe të gatshëm për t'ia nisur një beteje të vërtetë. ... edhe pse ata morën shumë plagë, prapë se prapë vazhduan të përlesheshin më tej duke goditur dhe dukë vrarë njëri tjetrin.*"<sup>61</sup>

Në këtë dasmë duket se humbën jetën shumë persona. Skënderbeu, i cili me autoritetin e tij do ta kishte zbutur këtë përleshje, në ato momente nuk ishte i pranishëm. Vrana Konti dhe Vladan Gjurica u plagosën ngaqë kishin guxuar që të futeshin midis palëve luftuese me qëllim për t'i ndarë. Pra, këtë përleshje midis dy princëve shqiptarë e gjejmë vetëm tek Biemmi, i cili nga ana e tij, shprehej se i kishte marrë të dhënat nga "anonimi tivaras". Disa muaj më vonë Lekë Zaharia u vra nga vrasës të paguar me porosi të Lekë Dukagjinit.

Ja si e përshkruan Biemmi këtë ngjarje: "*Lekë Zaharia (Zaccaria Altisfero), i zoti i Dejës u vra në pusi nga Lekë Dukagjini, i biri i Palit ... kur ai po kthehej për në shtëpi nga kështjella e Varosës, ku kishte bërë përgatitjet e fundit për martesën e tij me Irinin, të bijën e Gjergj Dushmanit, të vetmen trashëgimtare të asaj shtëpie.*"<sup>62</sup> Këtë vrasje e përmend edhe Barleti, dhe thekson anët negative të Lekë Dukagjinit, kur thotë se ishte "*burrë i dëgjuar për sukseset e shumta që pati në qëllimet e veta të këqija, megjithëse rridhte nga një babë shumë i mirë*"<sup>63</sup>.

Në fakt shkaku i kësaj armiqësie nuk duhet të ketë qenë vetëm Irini Dushmani, por vetë kështjella e Dejës aq shumë e dëshiruar qoftë nga Dukagjinët, qoftë nga Skënderbeu dhe qoftë nga Venediku që tashmë e kishte në zotërim këtë qytet-kështjellë strategjike. Leka arriti të depërtonte brenda në Dejë në vitin 1456, kryesisht me dredhi. Ai hiqej si

<sup>61</sup> "*Ivi la sua presenza accendo sempre più il fuoco della passione de suoi concorrenti, avvenne un giorno che due lor servitori essendo venuti alle mani, al punto di quel romore come ad un segnale che aspettavasi comparvero Alessio, e Zaccaria con tutta la gente loro sull' armi, e talmente preparati, e disposti, che non altrimenti di due giustebattaglie attaccarono un fiero conflitto: in cui dopo molte ferite ricevute da una parte, e dall' altra proseguiano tuttavia saldi nei lor posti a batrtersi, es ammazzarsi.*" G. Biemmi, *Istoria ...*, f. 85.

<sup>62</sup> "*Zaccaria Altisfero Signore di Dagnio fu assassinato dentro un'insidia da Alessio Ducagini figliolo di Paolo... mentre tornava a casa dall castello di Varosa, ove era stato a dare l'ultima mano ai trattati del matrimonio con Jerina figliuola unigenita di Giorgio Dusmano, et erede della paterna signoria.*" *Po aty*, f. 101.

<sup>63</sup> Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan J. Prifti, Tiranë: Mihal Duri, 1967, f. 139.

mik i venedikasve, duke i marrë atyre madje edhe para<sup>64</sup>, por nga ana tjetër ai u lidh me persona brenda kështjellës dhe madje arriti që të blinte me para edhe një oficer venedikas.<sup>65</sup> Megjithatë, Venediku kishte filluar tashmë të dyshonte prandaj armatosi mirë forcat mbrojtëse të kështjellës, dhe kur u hap fjala se në kështjellë kishte forca komplotiste mëkëmbësi venedikas Antonio Delfin arrestoi tetë të dyshuar.<sup>66</sup> Këto masa rezultuan si të kota pasi, në një natë të errët vjeshte njerëzit e Lekës u afruan me shkallë të matura saktë, u ngjitën në mure dhe hynë në banesën, ku banonte mëkëmbësi venedikas, të cilin e zunë në befasi duke fjetur.<sup>67</sup> Leka e çoi t'i prisnin kokën, përdhunoj vajzën e re e të bukur të princit<sup>68</sup> dhe i dëboi të shoqen me gjithë fëmijët në drejtim Shkodrës, lakuriq dhe në një gjendje të mjeruar. Nëse kapiteni i Shkodrës nuk do t'u kishte dalë rrugës për ndihmë me ushqim dhe gjëra të tjera të nevojshme ata me siguri do të kishin mbaruar nga të ftohtët dhe uria<sup>69</sup>. Gjatë këtyre përlëshjeve që u bënë në Dejë, pasi ishte zënë rob, Lekë Dukagjini i preu dorën e djathtë fisnikut Vasilio Hungaros, të cilit i ishin vrarë babai dhe vëllai në shërbim të Venedikut.<sup>70</sup> Ndër të tjerë ra viktimë edhe djali tashmë i rritur i komestablit të kështjellës, Baldesar de Forluxijs.<sup>71</sup> Kjo ngjarje duhet të ketë ndodhur më 29 tetor 1456.<sup>72</sup>

Leka më pas duket se mori zemër nga kjo fitore dhe deshi të nisej edhe kundër qytetit të Drishtit, qytetarët e të cilit ishin të sprovuar nëpër

<sup>64</sup> AAV XXIII, nr. 6379, 6388, 6390; O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 206

<sup>65</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 206

<sup>66</sup> *Po aty.*

<sup>67</sup> *Po aty.*

<sup>68</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 206.

<sup>69</sup> "... Antonij delphyni, qui dum foret prouisor lagni proditorie per Comestabilem deceptus cum lecha duchain stipendiarius et prouisionatus noster in Scutarum tamquam publicus Intransset dictum locum lagni, Fuit dum kaceret honorem nostrum ab ipso Lecha crudeliter et immanissime interfectus et acceptis quibusunque rebus suis fuerunt dicta vxor, filij, et filie spoliati et pessime in ordine missi versus Scutarum, et nisi Comes et Capitaneus noter Scutari subuenisset de passagio ac etiam pane, ac necessarijs ad vital vt huc venire possent fame et frigore penitus miserabiliter prituri erant." AAV XXIII, nr. 6508.

<sup>70</sup> "Quod Fideli nostrom Vasilio Hungaro quondam sami cuius pater, et frater in nostris seruicijs mortui fuit, et ipse in proxima guerra Dagni raptus fuit, et per Lecham Duchaino sibi fuit Incisa manus dextra..." AAV XXIII, nr. 6650.

<sup>71</sup> AAV XXIII, nr. 6629; AAV XXIII, nr. 6630

<sup>72</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 206.

luftëra.<sup>73</sup> Në ndihmë të drishtënjëve erdhën edhe shkodranët, kështu Leka u detyrua të zbrapset dhe pësoi një disfatë asgjësuese, për të cilën thuhet se u vranë dhe u mbytën në lumin Drin rreth 1200 luftëtarë të Lekës, ndërsa ai vetë mundi të shpëtonte kokën duke u arratisur nëpër male me rreth 60 shoqërues.<sup>74</sup>

Për Venedikun pushtimi i Dejës nga Lekë III Dukagjini përbënte një shqetësim. Sinjoria mori masa për ta marrë këtë qytet sa më shpejt që të ishte e mundur, sepse ngjarjet në Dejë kishin sjellë një situatë të vështirë edhe në Shkodër.<sup>75</sup> Megjithatë Lekë Dukagjini nuk mundi ta mbajë gjatë Dejën, sepse në qershor të vitit 1457, Sinjoria e mori përsëri këtë kështjellë. Këtë e mësojmë nga një letër e 6 shtatorit 1457 që Sinjoria i dërgonte kontkapitenit të Shkodrës “*U rimor me hirin e Zotit, vendi i Dejës, dhe nga të gjithë dihet tashmë sesa punë dhe kosto, e sa dëme dhe humbje nga ana e qytetarëve tanë u ka kushtuar kjo ndër marrje Zotërimit tonë*”.<sup>76</sup>

Në këtë goditje të Dejës, supozohej se kishte dorë edhe Alfonsi V i Napolit.<sup>77</sup> Venedikasit e donin Lekën të gjallë a të vdekur dhe si shpërblim jepnin 1000 dukatë për trupin e tij dhe 1500 dukatë nëse atë e kapte dhe e dorëzonte ndokush të gjallë. Ky njoftim u hap nëpër të gjitha posedimet venedikase në Shqipëri dhe në Kotorr.<sup>78</sup> Ai arriti të shpëtonte vetëm duke bërë aleancë me turqit, të cilët iu sulën trojeve të Skënderbeut, pasi Leka u kishte hapur atyre shtigjet.<sup>79</sup>

Fakti që Skënderbeu po bëhej më i fortë, ishte për Dukagjinët një gjë e pakëndshme kështu ata u afruan herë me Venedikun (1456) e herë

<sup>73</sup> *Po aty.*

<sup>74</sup> *Po aty.*

<sup>75</sup> L. Malltezi, “Skënderbeu dhe Dukagjinët...”, f. 95.

<sup>76</sup> “*Requisitus est per gratiam dei locus dagni, et omnibus notum est cum quanto labore et Impensa nostri dominij, Morte et iacturis Subditorum nostrorum obtenta est illa Impresa*”. AAV XXIII, nr. 6569.

<sup>77</sup> “*...quod Rex Aragonum faueat emulis nostris in illis partibus*”, AAV XXIII, nr. 6475; O. Schmitt, Skënderbeu ..., f. 207.

<sup>78</sup> “*Jtem che ditti Conte et prouededor nostri debiano publicar a dar taia che chi amazasse Lecha duchain debia hauer da la Camera nostra de Scutari dukati doro mille Chil presentasse viuo Millecinquecento. E questa taia sia proclamada per tuti logi ostri de albania ed a Cataro*”. AAV XXIII, nr. 6481.

<sup>79</sup> O. Schmitt, Skënderbeu ..., f. 207.

me osmanët (1457<sup>80</sup>) me ndihëm e të cilëve ata marrin Kështjellën e Satit, gjë që e bëri Skënderbeun të ndërhynte kundër Lekë Dukagjinit, me qëllim që të mënjanonte këtë pozicion të rrezikshëm prapa krahëve të tij. Ky armiqësim me Skënderbeun dhe aleanca e tyre me turqit shkaktoi për një farë kohe edhe shkishërimin e Dukagjinëve (Lekës dhe të vëllait të tij) nga papa Pali II<sup>81</sup>, edhe pse ata njiheshin për besimtarë të devotshëm.<sup>82</sup> Kjo aleancë me armikun e fesë e kishte armiqësuar Lekë Dukagjinin edhe me klerin katolik vendas.<sup>83</sup>

Pas disa vitesh armiqësi midis Skënderbeut dhe Dukagjinëve, që pikërisht ndërhyrja e Pal Engjëllit që Skënderbeu të pajtohej me Lekë Dukagjinin në vitin 1463<sup>84</sup>, pasi më parë Venediku e kishte provuar pa sukses, duke dërguar provizorin Gabriel Trevizano.<sup>85</sup> Pajtimi me Skënderbeun duhet të ketë ndodhur edhe për shkak të rritjes së kërcënimeve turke ndaj dukagjinave vetë, pasi territoret e tyre ishin drejtpërdrejtë në goditjet osmane. Megjithatë një degë e fisit (dega e vjetër dhe besnike ndaj Venedikut, për të cilën folëm shkurt edhe më sipër) e ruajti armiqësinë me Skënderbeun dhe si përfaqësues i kësaj dege mund të përmendim (*Drage Duchayno*)<sup>86</sup>, të birin e një farë Nikollë Dukagjini, i cili (Draga) në vitin 1462 u vra duke luftuar trimërisht për Venedikun,<sup>87</sup> por që nuk përjashtohet mundësia që ai të jetë vrarë pikërisht duke luftuar kundër kushërinjve të tij, që i përkisnin një dege më të re të Dukagjinave (ku bënte pjesë Leka (III) Dukagjini).<sup>88</sup> Duhet të përmendet këtu që kjo degë e cila e mbante veten si “Shtëpia e

<sup>80</sup> Gjatë këtij viti Leka duke e parë veten të kanosur qoftë nga Venediku, qoftë nga Skënderbeu u bë me osmanët dhe u liroi atyre qafat, si rrjedhojë qi u bë përgjegjës që një ushtri e madhe osmane goditi zemrën e territoreve të Skënderbeut duke i shkaktuar atij një disfatë të rëndë. AAV XXIII, nr. 6695; shih edhe: O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 207.

<sup>81</sup> Jovan Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV Veku (Istoriska Građa)*, Beograd: Srpska Kraljevska Akademija 1942, nr. 174; shih edhe: P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 230.

<sup>82</sup> M. Ahmeti, “Dukagjinët...”, në *Rilindasi*, suplement i gaz. *Shqiptarja.com*, viti IV, nr. 301, datë 21.12. 2014, f. 19.

<sup>83</sup> L. Malltezi, “Skënderbeu dhe Dukagjinët...”, f. 97.

<sup>84</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 230.

<sup>85</sup> L. Malltezi, “Skënderbeu dhe Dukagjinët...”, f. 99.

<sup>86</sup> AAV XXIII, nr. 6695.

<sup>87</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 230.

<sup>88</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 211.

Dukagjinëve të vërtetë” (*casa delli veri Ducagini*)<sup>89</sup> ishte vendosur me pasuri të mëdha në krahinat e Dibrit dhe të Fanit dhe fshatrat në posedimin e Dragës arrinin numrin 32.<sup>90</sup>

Por edhe pajtimi i Lekës me Skënderbeun u arrit, pasi Leka me të vëllanë më parë kishin bërë një marrëveshje paqeje më 19 shkurt 1459 në Shkodër, ku kishin qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit venedikas Benedetto Saronzo i Shkodrës, Luca Contarini i Lezhës dhe Cresio de Molini i i Drishtit, përfundimet e të cilave Skënderbeu nuk i pranoi, edhe pse ai vetë kishte marrë pjesë në traktativa.<sup>91</sup> Paqja u arrit me kusht që Leka të mos konsiderohej si vartës i tij.<sup>92</sup> Këtë Leka e shprehu më së miri në vjeshtën e vitit 1463, kur Venediku po mundohej ta fitonte atë si aleat në luftën e madhe kundër turqve.<sup>93</sup> Ja cilat janë fjalët e Lekës që ja tha françeskanit Eugjen që merrte pjesë në traktativa: “*Gjithashtu nuk dua të jem nën Skënderbeun, por jam mjaft i kënaqur të jem (të shërbej) nën çdo rektor apo proveditor të Sinjorisë suaj, nëse ajo e dëshiron këtë gjë, dhe t’i bindem asaj gjithmonë. Gjithashtu kërkoj, që në rast se Skënderbeu do të bënte luftë kundër meje, të kem ndihmën e Sinjorisë suaj të nderuar, dhe po ashtu po të bëja unë luftë kundër atij, jam dakord që të ndihmohet ai.*”<sup>94</sup> Megjithatë, nga këto momente e më vonë Dukagjinët kryesisht me në krye Lekë III Dukagjinin por edhe me Nikollë Dukagjinin morën pjesë aktive në luftën kundër osmanëve.

Sipas Barletit, kur vdiq Skënderbeu, i pari që u dha lajmin e mortit shqiptarëve, ishte pikërisht Leka. Ja si e përshkruan këtë rast Marin Barleti: “*Kur e dëgjoi që po e qanin të vdekur, Lek Dukagjini, Princ epirot... dolli me vrap në mes të pazarit dhe me fytyrë të pikëlluar e me zë të mbytur tha, duke çkukur mjekrën e flokët: «Mblidhuni me vrap të gjithë o princër, sot u bënë copë dyert e Epirit dhe të Maqedhonisë, sot u rrëzuan muret dhe fortesat tona; sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë; sot u përmbysën fronet dhe pushtetet tona; sot u shua krejt së bashku me*

<sup>89</sup> Po aty.

<sup>90</sup> AAV XXIII, nr. 6695.

<sup>91</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 210.

<sup>92</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 230.

<sup>93</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 211.

<sup>94</sup> “*Item non voglio esser soto Scanderbego Ma son ben contento esser soto qualunque rector o proveditore voglia La prefata. S<sup>ria</sup>. e stare Sempre a sua obediencia. Item Domando se scander[be]go me fesse gurra cha La sua. S<sup>ma</sup>. S<sup>ria</sup>. me dia auto e similiter se mi La fesse al dito Scander[be]go so contento aiuti lui*”. AAV XXV, nr. 7633.

*këtë njeri çdo shpresë e jonë».*<sup>95</sup> Kështu vajtoi pra për Skënderbeun Leka, i cili nuk kishte qenë aspak një shok besnik, por përkundrazi, për shumë kohë kishte qenë madje edhe armik i tij.<sup>96</sup>

Pas vdekjes së Skënderbeut, Leka III Dukagjini u bë një ndër figurat kryesore udhëheqëse në luftë kundër osmanëve duke luajtur një rol të rëndësishëm në fitoren e trupave shqiptare para mureve të Krujës në vitin 1477. Me emrin e Lekë Dukagjinit lidhet edhe një nga variantet e së Drejtës Zakonore shqiptare, i Ashtuquajturi Kanuni i Lekë Dukagjinit, për të cilin pretendohet se e ka origjinën tek dispozitat ligjore që ka nxjerrë vetë Lekë Dukagjini në kohën e tij.

Pas vitit 1479, pasi kishin rënë kështjellat kryesore si Lezha, Drishti, Kruja, Shkodra, etj., Nikolla dhe Lekë Dukagjini si shumë fisnikë të tjerë shqiptarë u detyruan të emigronin në Itali, për t'u kthyer përsëri disa vite më vonë, më 1481, pas vdekjes së Sulltan Mehmetit II, me shpresën se do të rifitonin sërish zotërimet që kishin pasur dikur.

### Vazhdimësi në Perandorinë Osmane

Një degë e kësaj familjeje – pasardhësit e njërit prej Lekëve, nëse i përmbahemi gjenealogjisë së dhënë nga Du Kanxhe<sup>97</sup>, të Lekës I – vazhdoi të ekzistonte në Perandorinë Osmane<sup>98</sup>. Nëse do të bazohemi tek Dhimitër Shuteriqi, ka pasur islamizim edhe në degën e Gjergjit I Dukagjinit. Nga kjo degë u islamizua dhe Pali IV, nipi i Gjergjit të sipërpërmendur, djali i dytë i Nikollës I dhe Anës, e cila ishte e bija e Gjergj Aranitit.<sup>99</sup> Pali IV Dukagjini (i njohur në vitet 1454-1457) u bë pasha turk dhe qëndroi si i tillë për disa kohë.<sup>100</sup> Po ashtu brenda kësaj linje u bë mysliman edhe Nikolla III, i biri i Gjergjit III Dukagjinit dhe i Helenës (bijës tjetër të Gjergj Aranitit\*).<sup>101</sup>

<sup>95</sup> M. Barleti, *Histori e Skënderbeut...*, f. 489.

<sup>96</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 230.

<sup>97</sup> Du Cange, *Historia Byzantina...*, f. 140.

<sup>98</sup> E. J. Brill's *First Encyclopedia of Islam: 1913-1936*, edited by M. Th. Houtsma. A. J. Wensinck, H. A. R. Gibb, W. Heffening and E. Lévi-Provençal. Reprint Edition. Volumen III. Leiden/ New York/ Köln: E. J. Brill 1993, f. 1144.

<sup>99</sup> Dhimitër S. Shuteriqi, *Aranitët (Histori, Gjenealogji, Zotërimet)*, përgatiti për botim Zana Shuteriqi Prela, Tiranë: Toena, 2011, f. 69.

<sup>100</sup> *Po aty*.

\* Duhet të sqarojmë këtu që Gjergj Araniti, duke u bazuar te kronologjia e Muzakës, kishte tetë vajza. Tri nga këto ishin martuar me djemtë e Gjergjit I Dukagjinit: Ana

Pra nga këto dy degë duhet të kenë dalë edhe Dukagjin-Zadetë që u bënë një ndër familjet më të famshme osmane<sup>102</sup>, nga e cila dolën vezirë dhe pashallarë. Përfaqësuesit e kësaj dege ishin rritur në oborrit e sulltanit dhe bënë atje karrierë. Prej këtyre mund të përmendim Vezirin e Madh të Perandorisë Osmane, Ahmet Pashë Dukagjinin (1512 -1515) (turqisht: *Dukakinoğlu Ahmed Paşa*; vdekur më 1515) të birin e tij guvernatorin e Egjiptit Dukagjin-zade Mehmet<sup>103</sup> dhe Dukagjin-zade Jahja Bej dhe Ali Bej.

Më i rëndësishmi i këtyre dukagjinave të përfunduar në Perandorinë Osmane është *Dukagjinzade Jahjabej* ose *Jahja Bej Dukagjini* (*Dukagjin-zâde Yahyâ bey or Taslicali Yahyâ bey*<sup>104</sup>) të cilit po i kushtojmë një hapësirë, me qëllim që të shkruajmë disa rreshta mbi jetën e tij. *Jahja Bej Dukagjini* u mor nga gjiri i familjes së tij në Shqipëri si pasojë e taksës së *divshirmesë* u dërgua në Stamboll në trupat e *Adjemi Oghlan*, ku përgatiteshin oficerët e jeniçerëve dhe të spahinjve.<sup>105</sup> Nuk e dimë akoma se i biri i kujt ishte.

Ai u bë oficer spahinjsh duke marrë gradat e *Jahja Bashit* dhe të *Bylyk Bashit*.<sup>106</sup> Më vonë u bë administrator i Bosnjës dhe qe ndër poetët e dëgjuar të periudhës klasike të letërsisë osmane të kohës së sulltan Sulejmanit, duke i lënë kësaj letërsie pesë mesnavi, nga të cilat fitoi popullaritet ajo me titull “Mbreti dhe lypsi” (*Shâh u gedâ*).<sup>107</sup> Ai u mundua të shpëtonte princin Mustafa, i cili ishte shumë popullor me ushtrinë dhe popullin, por që ra viktimë e Vezirit të Madh dhe të sulltaneshës Hyrriem (Khurram), por pa sukses, dhe kështu shkroi një elegji mbi princin Mustafa pas ekzekutimit të tij.<sup>108</sup> Kjo elegji u bë aq

(ose Kirana) u martua me Nikollën I Dukagjinin, djalin e madh të Gjergjit, Helena u martua me Gjergjin III Dukagjinin kurse Despina u martua me Tanushin IV Dukagjinin. Shih: *po aty*, f. 68-69.

<sup>101</sup> *Po aty*.

<sup>102</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu...*, f. 203

<sup>103</sup> Michael Winter, *Egyptian Society Under Ottoman Rule, 1517-1798*. London/ New York: Taylor & Francis 2004, f. 35.

<sup>104</sup> *History of the Literary Cultures of East-Central Europe: Junctures and Disjunctures in the 19th and 20th Centuries*. Volumen II. Edited by Marcel Cornis-Pope (Virginia Commonwealth University), John Neubauer (University of Amsterdam). Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company 2004, f. 286.

<sup>105</sup> *E. J. Brill's First Encyclopedia of Islam...*, vol. III, f. 1149.

<sup>106</sup> *Po aty*.

<sup>107</sup> *History of the Literary Cultures ...*, f. 286.

<sup>108</sup> *Po aty*.

popullore sa mund të dëgjohej në gojët e të gjithëve. Veziri i Madh u mundua që ta ekzekutonte edhe atë, por nuk ja doli, dhe i hoqi vetëm detyrën që kishte. Më vonë, vitet e fundit të jetës së tij ai i përfundoi në sanxhakun e Zvornikut në Bosnjë, ku vazhdoi të punojë në *divanet* dhe *gazelet* e tij, deri sa vdiq në vitin 1572.<sup>109</sup>

Mehmet Pashë Dukagjini (Dukagjinzade Mehmet apo Dukagin-Oğlu Mehmet Pasha) që përmendëm më sipër ishte pasha në Egjipt gjatë viteve 1554-6, dhe ndryshe nga pashatë e tjerë që në të shumtën e rasteve ishin besnikë ndaj Sharias (*Sheriatit*), bënte përjashtim në llojin e vet.<sup>110</sup> Ai njihet si njeri qejfli, që e kishte zakon të shkonte në breg të Nilit dhe të këndonte në publik, duke e shoqëruar këngën e tij me një lloj instrumenti me tela, të ngjashme me kitarrën, ai u thirr nga sulltan Sulejmani dhe u ekzekutua me vdekje, ngaqë kishte thyer ligjet e Sharias.<sup>111</sup> Këtu përmendëm vetëm disa pinjollë të rëndësishëm të këtij fisi, të vendosur në Perandorinë Osmane.

### Vazhdimësi në Istria

Degë të tjera të kësaj familjeje vazhduan të ekzistonin në Ankona dhe në Venedik, të cilat sipas Jirečekut, patën vazhdimësi deri në shek. XVII.<sup>112</sup> Në Marka të Ankonës jetoi Stefan Dukagjini, i cili ishte i biri i Lukës, vëllait të Nikollë dhe Lekë Dukagjinit.<sup>113</sup> Pasardhësit e Stefanit qenë Pali dhe Leka, të cilët kishin lindur në Markë.<sup>114</sup> Një degë e Dukagjinëve pas pushtimit të Shkodrës dhe të zonave përreth u vendos në Istria, që në atë kohë i përkiste Republikës së Venedikut. Në lidhje me Dukagjinët e Istrias kemi të dhëna më të bollshme se për Dukagjinët e vendosur në Perandorinë Osmane. Ata erdhën aty në vitet shtatëdhjetë të shek. XV, së bashku me shumë familje të tjera shqiptare, midis të cilave

<sup>109</sup> Për informacion të mëtejshëm në lidhje me veprat e tij shih: *po aty*.

<sup>110</sup> M. Winter, *Egyptian Society...*, f. 35.

<sup>111</sup> *Po aty*.

<sup>112</sup> Konstantin Jireček, "Albanien in der Vergangenheit", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 84.

<sup>113</sup> Gj. Muzaka, *Memorie...*, f. 51.

<sup>114</sup> *Po aty*.

shquhen familjet Bruni, Borisi Bruti, Carpaccio. Sipas, Prospero Petronios, “*ata pasi panë shumë vende, ata gjetën qytetin e Kapodistrias, i cili i korrespondonte fisnikërisë dhe nivelit të tyre dhe vendosën ta zgjidhnin atë për “atdhe”*”.<sup>115</sup>

Në një dokument venedikas të datës 8 maj 1479<sup>116</sup>, Senati venedikas merr vendim që t’i kërkojë rektorëve të Istrias, Zarës dhe kontëve të Nonas që në atë kohë ishin nën zotërimin venedikas, që të informohen në lidhje me gjendjen cilësinë dhe sasinë e tokave, pronave dhe shtëpive të lira në komunat dhe bashkitë e tyre, me qëllim që të strehojë dhe të vendosë “Shkodranët e shkretë” (*pauperibus scutarensis*), të cilët kishin ikur nga Shkodra e pushtuar tashmë dhe po prisnin që të akomodoreshin në atdheun e tyre të dytë, në trojet nën sundimin venedikas. Në mesin e këtyre të ardhurve ishin të pranishëm edhe pjesëtarë të familjes Dukagjini.

Të ardhurit e Dukagjinëve i përkisnin dy degëve të kësaj familjeje.





Fig. 5: Emblema e Dukagjinëve, nga P. Petronio, Brani ..., në: *Iliria*, nr. 2/2017 (Kopër, Slloveni), kopertina.

<sup>115</sup> “*Visti e girati molti luochi, e ritrovando la Città di Capodistria corrispondente à fatto al genio, e nobiltà de loro spiriti deliberarono d’elegersela per Patria.*” Prospero Petronio, *Brani della Parte Prima delle memorie sacre e profane dell’Istria, Memorie sacre degli anni 1680 e 81*, marrë nga: *Koper Regional Archives*. Fond: Rodbina Gravisi, Prospero Petronio, *Memorie Sacre e Profane dell’Istria*: Sign.: SI PAK/0299/008; shih edhe: Salvator Žitko, “La nobile famiglia albanese dei Ducaino”, në *Iliria*, nr. 2/2017 (Kopër, Slloveni), f. 19.

<sup>116</sup> “*Est Omnino necessarium pro honore nostri Domini dare expeditionem his pauperibus scutarensibus, qui qotindie ...Propterea vadit pars quod auctoritate hujus Consilii scribatur Rectoribus nostris istriae ac rectoribus Jadrae et Comitibus Nonae quod cum omnia diligentia intellegere debeant, si in civitatibus et in territoribus illis comunitati sint domus terrena et possessiones nostril domini et de conditione, quantitate et qualitate ac valor ipsarum per litteras suas particulariter et distincte, nostro dominio significare debeant*”. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1479-1506), pjesa I (1479-1499), përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1967, nr. 13.

Përfaqësuesit e grupit të parë ishin nga dega e Lekë (III) Dukagjinit, bashkëluftëtarit të Skënderbeut, por pasardhësit e tij qëndruan për një kohë të shkurtër në Istria e pastaj ikën. Kurse grupi tjetër i përkiste Gjon Dukagjinit një kushëriri të Lekës së lartpërmendur.\* I pari i tyre që u vendos në këtë qytet ishte Gjon (II) Dukagjini (Giovanni Ducaino) me familje, i cili fillimisht duhet të jetë vendosur në fshatin Dekani (Decani), që sipas Petronius dhe Kandlerit<sup>117</sup> ishte themeluar pikërisht nga Dukagjinët, të cilët i dhanë këtij fshati edhe emrin e tyre (Dekani).<sup>118</sup> Megjithatë në lidhje me emrin e këtij fshati dhe me çështjen e ekzistencës së tij para ardhjes së Dukagjinëve, tek studiuesit istriani ka edhe mendime të tjera.



**Fig. 7:** Harta e fshatit Cani (Decani) Istria (Slloveni). Marrë nga: S. Žitko, “La nobile famiglia albanese dei Ducaino”, në: *Iliria*, nr. 2/2017 (Kopër, Slloveni), f. 20.

\* Në lidhje me degëzimin shih Pemën gjenealogjike të Petronios të dhënë më poshtë.

<sup>117</sup> Pietro Kandler, *Codice diplomatico Istriano*, vol. 4: Anni 1400-1499, Triest: Tipografia del Lloyd Austriaco, 1850, f. 2037.

<sup>118</sup> S. Žitko, “La nobile famiglia albanese dei Ducaino ...”, në *Iliria*, nr. 2/2017, f. 20.

Salvator Žitko në lidhje me këtë fshat na informon që ai i përkiste familjes *De Cano* që në vitin 1300, dhe me siguri edhe në vitet 1400.<sup>119</sup> Po sipas Žitkos, *Damianus Canis* që ishte njëri ndër pinjollët e kësaj shtëpie fisnike, rezulton të ketë qenë anëtar i Këshillit të Madh të Koprit, dhe në shtëpinë e tyre duket se është ruajtur edhe simboli i familjes *De Cani* dhe përshkrimi që i bën *Petronio* në dorëshkrimin e tij nuk korrespondon me stemën e sotme që ndodhet e murosur në faqen e shtëpisë *Mahnič-Piciga*, të cilën *A. Tommasich* e lidh me fisnikët *Dukagjini*.<sup>120</sup>

Autori triestin *Paolo Muner*, duke u bazuar tek autori *Dario Alberi*, i jep një origjinë tjetër këtij fshati. Ai shkruan që “Realiteti historik është më i ndërlikuar, pasi në të vërtetë ishin dy të mërguar shqiptarë. Në veprën e tij të njohur për Istriën, *Dario Alberi* shkroi kështu: “*Dekani (Villa Decani) ... u bë vendbanim pas vitit, 1480, kur Senati i Venedikut mori vendim që Giovanni Ducainit, shqiptarit të Shkodrës e fisnikut në principatën shqiptare të Dukagjinit, njërit nga të zotët e Socerbit, t’i njihet e drejta e banimit të përhershëm sikur një fisniku të Koprit*”<sup>121</sup>. Më pas, po sipas *Alberit*, “*Dekani (Villa Decani) e mori emrin nga fisniku i Koprit Decano ose De Cano i cili rrjedh nga familja e vjetër Sulmone nga Abruci, e më vonë u vendos në Shqipëri dhe ndoshta ishte mik i Dukainit. Vendi e mori emrin Villa Dukaina...*”<sup>122</sup>.

Pra në lidhje me themelimin e këtij fshati nuk kemi akoma një përgjigje përfundimtare, por fakt është që në të u vendosën Dukagjinët, të cilët pas vitit 1480 duhet ta kenë populluar përsëri. Pak më vonë Dukagjinët u bënë zotër edhe të kështjellës të San Servolos, jo shumë larg nga qyteti i Kapodistrias (Koper). Këtë kështjellë, që përfshinte edhe disa fshatra përreth, ata e paguan me monedha floriri dhe në lidhje me blerjen e saj ekziston edhe një dokument që e vërteton këtë. Dokumentin po e japim në gjuhën latine dhe të përkthyer në shqip si më poshtë:

**7. dhjetor 1480, indikacioni i 14-të. Venedik. Dogji Giovanni Mocenigo e lavdëron emërimin për kështjellar të San Servolos**

<sup>119</sup> Po aty, f. 22.

<sup>120</sup> Po aty.

<sup>121</sup> *Paolo Muner*, “Il caso della famiglia Dukagjini (a Villa Decani), nel piu vasto tema degli insediamenti di profughi albanesi nei territori già della Repubblica di Venezia”, në *Iliria*, nr 2/2017 (Koper, Slloveni), f. 28.

<sup>122</sup> Po aty, f. 29.

**(Socerbit) shkodranin e shumëmerituar Giovanni Ducainin, sipas të cilit është emërtuar fshati i tij, që sot quhet de Cani ose Decani. (Arkivi Bashkiak i Kapodistrias/ Kopërit)**

Giovanni Mocenigo, Prijës i Venedikasve me Hirin e Perëndisë etj., u çoj të fala dhe konsideratat e mia burrave fisnikë, Dominico Maurocenit, gjatë mandatit tim Podesta e Kapedan i Justinopolit, si dhe ithtarëve të tij besnikë. Përveç vendimeve lidhur me shkodranët, sipas të cilave me autorizimin e Këshillit tonë që t'u shprehen nderimet dhe pagesat e duhura shkodranëve shumë të meritueshëm, të cilët derisa ishin në shërbimin e Zotërimit tonë, treguan trimëri me rastin e rrethimit të fundit, burrat tanë të urtë e shembullorë vendosën edhe ta emërojnë për kështjellar të Socerbit në luginën tonë tek vendi Mokovo, në vend të fisnikut Filip Minios, i cili nuk e pranoi këtë nder, fisnikun shkodran të merituar dhe më se besnik Giovanni Ducainin, i cili me burrëri dhe me besnikëri i bëri ballë vështirësive derisa që në shërbimin e zotërimit tonë dhe lavdisë së Zotit, duke rrezikuar edhe vetë jetën e duke dëshmuar besnikërinë e tij. Përfundoj se emërimi u bë në mënyrë të rregullt, sipas ligjeve tona dhe në frymën e dokeve tona, prandaj e miratoj dhe e mbështes atë. Për këtë kërkoj në mënyrë të qartë dhe efikase që Giovanni ynë i sipërpërmendur dhe shumë besnik, të pranohet si kështjellar i fortesës së lartpërmendur të San Servolos (Socerbit), në vendin e lartpërmendur të fisnikërisë sonë, duke i siguruar atij pagesën dhe gjithçka që i përket sipas kësaj pozite, duke përfshirë tri pagat e paguara në avancë. Në lidhje me këtë nuk dyshoj në besnikërinë dhe në bindjen tuaj dhe jam i bindur se këtë udhëzim timin do ta zbatoni në tërësi. Këtë vendimin tonë regjistrojeni që të ruhet në kujtesë për të ardhmen dhe regjistrat t'i ripërtini sa herë të jetë nevoja. Dhënë në pallatin tonë duka, më 7 dhjetor 1480, indikacioni i 14-të.<sup>123</sup>

<sup>123</sup> Teksti në origjinal: “Anno 1480. 7 Decembre, Indizione XIII. Venezia. Doge Giovanni Mocenigo loda la nomina in Castellano di S. Servolo Del benemerito Scutarino Giovanni Duchayno, dal quale venne il nome alla villa sua, ora dei Cani, o Decani. (Archivio Municipale di Capodistria). Joannes Mocenigo Dei gratia Dux Venetiarum etc. Nobilibus et sapientibus Viris Dominico Mauroceno de suo mandato Potestati et Capitaneo Justinopolis, et successoribus suis fidelibus dilectis, salutem et dilectionis affectum. Viri Nobiles sapientes nostri supra provisionibus Scutarensium qui a nostrum majore Consilio habuerunt amplam et plenam facultatem providendi et beneficia conferendi fidelissimis et de dominio nostro benemeritis Scutarensibus, qui tempore ultime obsidionis optime et fideliter se gesserunt, auctoritate suprascripta elegerunt in Castellatum Sancti Servuli in Valle nostra Mocho loco Viri nobilis Philippo Minio qui refutavit, fidelissimum et de dominio nostrum benemeritum

Këtë emërim të Gjon Dukagjinit, Dogji Venedikas Johanes Mozenigo (ose Joannes Mocenigo) e konfirmon edhe tre muaj më vonë, ngaqë nga krerët e Kapodistriias (Koperit) (në gjuhën e atëhershme *Justinopolit*) ishte zgjedhur një tjetër person i quajtur *Joanes de Jonerius* nga fisnikëria e këtij qyteti, për ta vendosur si kështjellar të San Servolos. Në lidhje me këtë emërim duhet të ketë pasur një rivalitet të madh, midis vendasve dhe të ardhurve, pasi dogji i sipërpërmendur kapodistriianin Joanes de Jonerius-in e kishte emëruar kështjellar të kësaj kështjelle më 21 dhjetor 1480<sup>124</sup>, duke e anashkaluar Gjon Dukagjinit që ishte vendosur tashmë si i tillë më 7 dhjetor 1480, pra duke rënë ndesh me vendimin e tij të mëparshëm. Ky gabim korrigjohet disa muaj më vonë.



**Fig. 8:** Kështjella e San Servolos në Istria (Slloveni).  
Foto: Edmond Malaj, 2016.

Dogji e rikonfirmon emërimin e Gjon Dukagjinit më 14 mars 1481, duke përmendur edhe një herë tri pagesat avancë që duhet t'i bënin

*Joannem Duchaynum nobilem Scutarenses, qui spretis laboribus facultatem et propria vita tempore obsidionis, pro honore Dei dominiique nostri virilitet et fidelem se gessit: quamquidem electionem recte et debite factam, et juxta formam legum et ordinum nostrorum laudavimus et approbavimus. Mandantes vobis efficaciter et expresse ut predictum Joannem fidelissimum nostrum acceptare et acceptari facere pro Castellano ad dictam bastitam Sancti Servuli locho antedicti nobilis nostri cum omnibus Salaris et utilitatibus solitis debeatis non dubitamus pro fide et laudabili obedientia vestra vos omnia futuros esse dando ei pecuniam trium mensium anteactorum: Has autem nostras ad futurorum memoriam registrari facite et registratas presentati restituite. Dato in nostro ducali palatio die VII Decemb, Indictione XIII, M.CCCC.LXXX.” P. Kandler, Codice diplomatico Istriano ..., vol. 4, nr. 1206.*

<sup>124</sup> “...Et speramus multiplici ratione fidele et optimum servitium, predictum Joannem Jonerius confirmamus et facimus Castellanus dicte Bastite, cum utilitatibus modis et conditionibus quas habebant predecessores sui...”. *Po aty*, nr. 1207.

organet e Capodistriasi (Justinopolit).<sup>125</sup> Më tej nuk kemi më lajme në lidhje me vazhdimësinë e Dukagjinave në këtë krahinë, por dimë që familja e tyre vazhdoi të ekzistonte deri në shek. XVII deri sa u shua në vitin 1609 dhe pinjollët e fundit të kësaj familjeje qenë Nikolla dhe Gjon Dukagjini, të bijtë e Dr. Pal Dukagjinit, i cili njihej si ekspert i së drejtës, për të cilën kishte edhe gradën Doktor.<sup>126</sup>

### Gjenealogjitë e Dukagjinëve

Pasi folëm tashmë mbi historinë e tyre është me vlerë që të paraqesim si përfundim edhe tri gjenealogji të kësaj familjeje, të cilat nuk janë botuar akoma në gjuhën shqipe. Gjenealogjia e parë vjen nga vepra e

<sup>125</sup> “Anno 1481. 14 Marzo, Indizione XIV. Venezia. Doge Giovanni Mocenigo ordina di rimettere nel Capitanata di Castelnovo lo scutarino Giovanni Ducaz'no. (Archivio Municipale di Capodistria). *Joannes Mozenigo Dei gratia Dux Venetiarum. Nobilibus et sapientibus viris Dominico Mauroceno de suo mandato Potestati et Capitaneo Justinopolis, et successoribus suis fidelibus dilectis salutem et dilectionis affectum. Alias sub die septimo mensis decembris proxime preteriti Vobis scripsimus ut juxta electionem et deputationem per quinque Nobiles nostros supra provisionibus Scutarensium factam de fedelissimo nostro Joanne Duchayno cive et nobile Scutarensis in Castellano S. Servuli loco nobilis nostri Philippi Minio qui refutavit, et memores vobis scripsisse superioribus diebus ut in confirmationem Electionis Vestre de Joanne de Joneriis per vos electo, que res certe nobis mo lesta fuita quia non intelligebamus vobis scripsisse literas nostras ad requisitionem Sapientum predictorum. Qui sapientes nostri habuerunt a nostro Majori consilio amplissimum libertatem providendi et beneficia conferendi fidelissimis nostri Scutarensibus tum de officiis istius nostre Venetiarum civitatis quam ceterarum et locorum nostrorum. Et propterea has nostras de integro vobis scribere deliberavimus volentes, et vobis efficacissime injungentes quatenus prefactum Joannem Duchaynum per quem alias vobis juste ad instantiam Sapientum nostrorum predictorum scripsimus acceptare et quam primum ponere debeatis non obstante litera per nos scripta circa Joannem de Joneriis pro Castellano in dicta. bastita S. Servuli, quia semper fuit et est nostre intentionis conservare electiones per prefatos Suplentes factas in suprascriptis Scutarensibus cum omnibus salario modis et conditionibus predecessorum suorum, dando predicto johanni Duchayno prestantiam trium mensium anteaquorum quemadmodum consuetum est. Hec autem registrari facite et registratas presentanti restituite. Data in nostro ducali palatio die XIII Marcii. Indictione XIII, MCCCCLXXXI” P. Kandler, *Codice diplomatico Istriano...*, vol. 4, nr. 1209.*

<sup>126</sup> *Koper Regional Archives*. Fond: Rodbina Gravisi, Prospero Petronio, Memorie Sacre e Profane dell'Istria: Sign.: SI PAK/0299/008. Shih edhe: S. Žitko, “La nobile famiglia albanese dei Ducaino ...”, në *Iliria*, nr 2/2017, f. 19.

mirënjohur me titull “*Historia bizantine e paraqitur me një komentat të dyfishtë*” (lat. *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*) e autorit Carolo Du Fresne Domino Du Cange, (v. 1729). Gjenealogjinë e dytë e kam nxjerrë nga vepra me titull “Kujtime të shenjta dhe profane të Istrias” (ital. *Memorie sacre e profane dell’Istria, Memorie sacre degli anni 1680 e 81*) e autorit istrian Prospero Petronius, i cili bazohet tek gjenealogjia e Andrea Engjëllit, ndërsa Gjenealogjia e tretë është nxjerrë nga vepra e Ivan Bozhiq “Nemirno Pomorje u XV veka”, nga kapitulli që u kushtohet Dukagjinëve (*O Dukadinima*).<sup>127</sup>

Kurse një gjenealogji tjetër, por shumë e shkurtër dhe të botuar në shqip, e jep edhe Oliver Jens Schmitt, i cili e ndan këtë fis në tri degë: Linja e parë përbëhet nga Leka i Vjetri († para vitit 1451) me të birin Lekën e Ri († pas vitit 1481); linja tjetër, më e re nga Pali († para vitit 1458) me të bijtë Nikollën († pas vitit 1481) dhe Progonin († para vitit 1471), linja e tretë, e vjetra përbëhet nga Pali, me të birin Nikollën († para vitit 1454), i cili ishte i ati i Dragës († para vitit 1462).<sup>128</sup> Le të ndalemi tani në dy gjenealogjitë e panjohura.

<sup>127</sup> I. Božić, “O Dukadinima”, f. 344.

<sup>128</sup> O. Schmitt, *Skënderbeu...*, f. 203.




Fig. 9: Genealogjia e dhënë nga Du Cange, *Historia Byzantina...* f. 140.

Një gjenealogji tjetër që është më e plotë, na vjen nga autori istrian Prospero Petronio, i cili në veprën e tij mbi historinë e Istrias, me titull “Kujtime të shenjta dhe profane të Istrias” (ital. *Memorie sacre e profane dell’Istria, Memorie sacre degli anni 1680 e 81*)<sup>129</sup>, ndër të tjera merret edhe me gjenealogjinë e Dukagjinëve, të cilët tashmë pas pushtimit osman, siç e pamë edhe më sipër gjendeshin edhe në Istria, ku zinin një vend në aristokracinë lokale.

Përsa i përket burimit të kësaj gjenealogjie që po paraqes më poshtë, Petronius thotë se është bazuar edhe tek gjenealogjia e Andrea Engjëllit, por pasi konsultova një ekzemplar të kësaj gjenealogjie<sup>130</sup>, rezultoi që aty nuk kishte një gjenealogji të tyre të mirëfilltë, megjithatë emri i tyre, ndeshet disa herë brenda kësaj vepre, në lidhje me martesat e tyre me familje të tjera, dhe në faqet 4 dhe 5 duke filluar nga faqja e fundit, jepen disa breza të tyre, megjithatë diçka jo e plotë. Vepra nuk ka numra faqeje. Më poshtë po paraqes gjenealogjinë e Prospero Petronios, si në dorëshkrimin origjinal ashtu edhe të transkriptuar e të përkthyer në gjuhën shqipe:

---

<sup>129</sup> Prospero Petronio, *Branì della Parte Prima delle memorie sacre e profane dell’Istria, Memorie sacre degli anni 1680 e 81*, marrë nga: *Koper Regional Archives*. Fond: Rodbina Gravisi, Prospero Petronio, Memorie Sacre e Profane dell’Istria: Sign.: SI PAK/0299/008; shih edhe botimin: “Kontët Shqiptarë Dukagjini në Kopër”, në *Iliria*, nr 2/2017 (Kopër, Slloveni).

<sup>130</sup> *Genealogia Imperatorvm ac Regvm Aliorumque, Principvm, et Illvstrium Virorum, Ab Adamo usque ad annum M.D.LV*. Romae: apud Valerium, & Aloysium Doricos: sumptibus Andreae Philippi Angeli (1560). Kjo vepër rezultoi e botuar edhe në versione të mëparshme në vitet 1551, 1552, 1553, 1553, 1555, 1621, me një ribotim edhe në vitin 1869.






Fig. 11: Gjenealogjia e Dukagjinëve, nga dorëshkrimi i P. Petronio, Brani ....., shih fig. 7.




Fig. 12: Gjenealogjia e dhënë nga I. Božić, "O Dukadinima", f. 344.

*S u m m a r y*DUKAGJINIS IN THE MIDDLE AGES. THE GEOGRAPHICAL AREA  
AND SOME CHARACTERISTICS

In this article we will try to give a general overview on the history of Dukagjinis which consisted of some families seemingly belonging to the same tribe and were part of the Albanian nobles in the Middle Ages. Dukagjinis show up many a time in documents and they were an important factor in the occurrences taking place in Albania in the Middle Ages, especially during Skanderbeg's period. Besides the expansion of their prevalence in North Albanian regions and their distribution into some European countries after the Ottoman occupation they result to be present even among noble Albanian families with the highest duration until they died out in the 17<sup>th</sup> century. In this paper besides the historical data about them in Albanian territories you will also find information on their presence in Italy, Istria and Ottoman Empire.

